



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:114493
Datë: 23.07.2024
Numri i dokumentit: 05971112

C.nr.1745/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sheremet Ademi, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurit Universiteti "I. B.", në M., me objekt kontesti kompensim i shujtës ushqimore, në seancën gjyqësore të datës 17.07.2024, në prani të të autorizuarit të të paditurit, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit A.M. nga M., e ushtruar kundër të paditurit Universiteti "Isa Boletini", në Mitrovicë, me objekt kontesti kompensim i shujtës ushqimore, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.M. nga M., pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurit Universiteti "I. B.", në M., me objekt kontesti kompensim i shujtës ushqimore.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore gjykata më datë 17.07.2024, ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor në të cilën nuk ka prezentuar paditësi edhe pse i njëjti është ftuar në mënyrë

të rregullt por ka prezentuar vetëm përfaqësuesi i të paditurit, i cili nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësit.

Nga procesverbali i datës 28.06.2024, i përpiluar pranë kësaj gjykte, për këtë çështje juridike, rezulton se përfaqësuesi i paditësit është njoftuar për kohën e mbajtjes së seancës së radhës në këtë çështje juridike, respektivisht për seancën e datës 17.07.2024 në ora 15:00, duke i bërë të ditur se gjykata nuk do të dërgojë ftesë tjetër për këtë seancë, të cilin procesverbal e ka nënshkruar edhe përfaqësuesi i paditësit, mirëpo megjithatë në seancë nuk ka prezentuar as paditësi dhe as përfaqësuesi i tij dhe mosprezencën nuk e kanë arsyetuar, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), e cila parasheh se: *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, duke qenë se edhe përfaqësuesi i të paditurës nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të paditësit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 lidhur me nenin 453 par.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1745/2024 më datë 17.07.2024

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.